



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 400/dl-47880 dt. 13/09/ 2022

Procesverbali i Dëgjimeve Publike për listën e Projekteve kapitale për Buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitin 2024-2025 në Sallën e Kuvendit të Komunës

DËGJIMI PUBLIK ME SHOQATAT E GRAVE DRENAS



Njoftimi për organizimin e dëgjimeve publike për listën e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025 u bë me dt: 01.09.2022 në ueb faqen e komunës së Drenasit, në këtë vegës: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/neës/ftese-per-degjime-publike-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-buxhetin-e-vitit-2023-dhe-projeksioneve-per-vitet-2024-2025/> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton udhëzimi Administrativ si vijon:

Bazuar në nenin 68, paragrafi 68.1 të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Nr.110-6904 i dt. 24.09.2008 dhe Propozim ndryshimin e Statutit të Komunës nr. 112-10030 i dt. 16.02.2018, si dhe Rregullores Komunale për Transparencë nr.i protokollit 12-030-63551 i dt. 30.10.2019 dhe nën organizimin e Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe Anëtareve të Komitetit për Politikë dhe Financa organizohen 8 dëgjime publike me qytetar për listën e Projekteve Kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.

Me qellim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e Komunës së Drenasit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve publike me qytetar janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i orarizimit të dëgjimeve publike në ueb faqen zyrtare të komunës si dhe në rrjetin social facebook, njoftimi në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/neës/ftese-per-degjime-publike-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-buxhetin-e-vitit-2023-dhe-projeksioneve-per-vitet-2024-2025/>

Njoftimet përveç që janë publikuar në ueb faqen e Komunës së Drenasit në platformen për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë bërë përmes telefonit.

Fillon cikli i dëgjimeve publike për Projektet Kapitale të buxhetit 2023- 2025
Komuna e Drenasit, përkatësisht Kuvendi Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës, kanë filluar mbajtjen e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për të diskutuar lidhur me listën e Projektet Kapitale për periudhën 2023-2025.
Të mërkurën me dt. **07.09.2022** në ora 14:00 është mbajtur dëgjimi i dytë në Sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit me përfaqësues të Shoqatave të grave.

Këto Dëgjime Buxhetore për Projekte Kapitale janë organizuar nga Zyra e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Takimin e dytë e prezantoi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun Bekim Dobra, ndërsa merrnin pjesë, Nënkryetari i Komunës, Arben Shala, Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hjadari, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësuese të Shoqatave të grave.

Pjesëmarrëse në këtë dëgjim dhe zyrtar komunal ishin gjithsej 34 pjesëmarrës:

- **Femra ishin:25**
- **Meshkuj: 9**

Të gjitha të pranishmet janë pajisur me materialet e nevojshme për të diskutuar. Ato para vetës kanë pasur draft-listën e projekteve kapitale si dhe draft-buxhetin për vitet 2023-2025 dhe pasi kanë paraqitur kërkesat e tyre kanë marrë përgjigje për kërkesat e parashtruara. Ndryshe, buxheti i përgjithshëm i Komunës për vitin 2023 është 18.156.892.00 euro, ndërsa nga kjo shumë për investime kapitale janë planifikuar 6.335.649.00 euro apo 34.89%. Takimet për Listën e projekteve kapitale do të zhvillohen më këtë rend dite.

1. Lista e projekteve kapitale për vitet 2023-2025,
2. Prioritete tuaja.

Të pranishmet i kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat e tyre për të cilat kanë kërkuar të futen si Projektet Kapitale 2023- 2025.

Bekim Dobra, pasi përshëndeti të pranishmit, theksoj se lista e projekteve kapitale është e një rëndësie të veçantë për vendbanimet e Komunës se Drenasit andaj ju qytetar, duhet të shfrytëzoni të drejtën tuaj dhe të caktoni prioritet për vendbanimet tuaja në mënyrë që të përcaktohen sa më mirë prioritet tuaja. Këtë rëndësi të veçantë ku do na shërbejë që të përcaktohen prioritet për vendbanime, lagje, dhe lista e investimeve kapitale të jetë sa më e kompletuar, dhe të i përfshij nevojat e vendbanimeve tona, për të përmirësuar jetën tuaj.

Milaim Hajdari- Kryesues i Kuvendit Komunal, Të nderuar të pranishëm,

Mirë se keni ardhur në këtë takim të thirrur nga Kuvendi i Komunës, në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale.

Jemi mbledhur sot ne këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar draft-Listën e Investimeve Kapitale për vitin 2023 dhe projeksionet e investimeve për vitet 2024, 2025. Siç ju tregoj edhe shefi i Zyrës për Informim, Bekimi, kjo listë ende mbetet si draft deri në miratimin e saj në mbledhjen e Kuvendit më së largu me 30 shtator të këtij viti, prandaj është mirë që të fokusoheni në këtë listë që keni para vetes dhe të jepni propozime, ide konkrete të projekteve që janë me interes të përgjithshëm të vendbanimit që ju përfaqësoni.

Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën për mbajtjen e këtij takimi ndërsa që nga muaji Maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertet, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar ne hartimin e këtij dokumenti.

Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë ka bërë publike, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025 dhe draft-Listën e Investimeve Kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës. Këto dy dokumente janë votuar në mbledhje të Kuvendit dhe na kanë dhënë dritën jeshile për të dalë në diskutim publik, këto dëgjime që po i mbajnë tani, ndaj kërkojë nga ana juaj që të diskutoni reciprokisht me qëllim që të behët një përmbledhje me interes të përgjithshëm për të gjithë qytetarët e Komunës së

Drenasit. Presim komente, projekte e ide që të futen ne këtë listë sipas mundësive buxhetore, para se i njëjti dokument të miratohet në mbledhje të Kuvendit.

Ju faleminderit shumë që keni gjetur kohën të jeni pjesë e këtij takimi.

Kadire Tahiraj-Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave-Drenas, pasi përshëndeti të pranishmit, theksoj se grat e Drenasit kanë nevojë të realizojnë projektet në fuqizimin ekonomik, po ashtu kërkoj ndarjen e një fondi emergjent për trajtimin e rasteve, viktimave të dhunës në familje, pasi që kemi shumë ankesa dhe kërkesa nga vete viktimat gjatë qëndrimit një-dy orë nuk kane mjete për gjera elementare qoftë edhe për ushqim, se paku te kemi një fond dhe t'i ndihmojmë këtyre rasteve. Për ndryshe theksoj se ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Komunën e Drenasit.

Drejtori i Financave-Shyqiri Bublaku, Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave-Drenas duhet të bëjnë kërkesë me shkrim sepse kjo nuk hyn ne kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe kur të hartohet buxheti t'i parashohin raste të tilla.

Pasi nuk pati diskutime të tjera takimi përfundoj rreth orës 14:30 min.



Procesmbajtëse:

Fejza Ajazi
Fejza Ajazi